

L I G J
Nr. 8983, datë 20.12.2002

PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2003

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
BUXHETI I SHTETIT

Neni 1

Fondi i konsoliduar për vitin 2003 është:	
Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.....	145 107 milionë lekë
Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit.....	192 762 milionë lekë
Deficiti.....	47 655 milionë lekë
Fondi i konsoliduar përbëhet nga:	
A) Buxheti qendror	
Të ardhurat.....	137 053 milionë lekë
Shpenzimet.....	184 708 milionë lekë
B) Buxheti i pavarur i pushtetit vendor	
Të ardhurat.....	14 354 milionë lekë
Nga të cilat:	
Granti nga buxheti qendror.....	6 300 milionë lekë
Shpenzimet.....	14 354 milionë lekë

Neni 2

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2003 është:

A. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat gjithsej.....	37 563 milionë lekë
Nga kontributet.....	28 161 milionë lekë
Transferimet nga Buxheti i Shtetit.....	9 402 milionë lekë
Shpenzimet.....	37 563 milionë lekë

Paga minimale për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, deri në rritjen e pagave, është 9 403 lekë në muaj. Pas rritjes së pagave, Këshilli i Ministrave përcakton pagën e re.

B. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat gjithsej.....	2 910 milionë lekë
Nga kontributet.....	39 milionë lekë
Transferimet nga Buxheti i Shtetit.....	2 871 milionë lekë
Nga të cilat:	
Sigurimi suplementar i ushtarakut.....	1 184 milionë lekë
Sigurimet suplementare shtetërore.....	138 milionë lekë
Pagesat e parakohshme për minatorët.....	505 milionë lekë
Statusi i dëshmorit.....	1 044 milionë lekë
Shpenzimet.....	2 910 milionë lekë

Neni 3

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2003 është:

Të ardhurat gjithsej.....	4 559 milionë lekë
Nga kontributet dhe të tjera.....	2 459 milionë lekë
Transferimet nga Buxheti i Shtetit.....	2 100 milionë lekë
Shpenzimet.....	4 559 milionë lekë

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE BUXHETORE

Neni 4

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Të ardhurat tatimore.....	115 174 milionë lekë
Nga e cila taksa e Rugës Durrës Kukës.....	3 000 milionë lekë
Të ardhurat jotatimore.....	21 879 milionë lekë
Të ardhurat e buxhetit vendor.....	8 054 milionë lekë

Neni 5

Taksa e Rugës Durrës-Kukës e mbledhur gjatë vitit 2002 dhe 2003 dhe e papërdorur gjatë vitit 2003 të shërbejë si burim financimi për Rugën Durrës-Kukës në vitet në vijim.

Neni 6

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme është 21 143 milionë lekë, nga i cili 1 077 milionë lekë financohet nga të ardhurat e privatizimit. Në rast të mosrealizimit të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm prej 20 066 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burimet suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Kufiri i financimit nga burimet e huaja është 26 512 milionë lekë, nga i cili mbështetje e drejtpërdrejtë për deficitin është 2 596 milionë lekë.

Neni 7

Disbalancimi i mundshëm gjatë vitit i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore financohet nga fondi i garantimit të pensioneve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe fondi rezervë i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH).

KREU III

SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 8

Shpenzimet sipas drejtimeve kryesore janë:

Shpenzime korrente.....	137 795 milionë lekë
Shpenzimet kapitale.....	49 167 milionë lekë
Rezerva e Këshillit të Ministrave.....	2 000 milionë lekë
Kontingjenca.....	3 800 milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 9

Kufiri i shpenzimeve për institucionet e pavarura është si më poshtë:

Kontrolli i Lartë i Shtetit.....	174 710 mijë lekë
Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.....	1 005 413 mijë lekë
Gjykata Kushtetuese.....	97 000mijë lekë
Komisioni i Letrave me Vlerë.....	24 000 mijë lekë
Shkolla e Magjistraturës.....	48 892 mijë lekë
Zyra e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	24 544 mijë lekë
Këshilli Kombëtar i RTV.....	73 000 mijë lekë
Avokati i Popullit.....	86 889 mijë lekë
Komisioni i Shërbimit Civil.....	57 440 mijë lekë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	136 000 mijë lekë

Ky kufi mund të ndryshojë për efekt të rritjes së pagave ose nga përdorimi i fondit rezervë të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Numri maksimal i punonjësve buxhetorë, mbi të cilin është përgatitur Buxheti i Shtetit të vitit 2003 (më 1 janar 2003), është 110 000 punonjës. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë numrin e punonjësve buxhetorë dhe fondin e pagave për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi për rritjen e pagave përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me politikat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 11

Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme janë 21 206 milionë lekë dhe nga burimet e huaja 27 961 milionë lekë. Investimet, sipas ministrive dhe institucioneve, paraqiten në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 12

Fondi i kontingjencës prej 3 800 milionë lekësh përdoret:

- për ruajtjen e deficitit, me miratim të Kuvendit, 1 000 milionë lekë;
- me vendim të Këshillit të Ministrave, 2 000 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të vjetra të ndërmarrjeve publike, që lidhen me energjinë;
- për zgjedhjet vendore, 400 milionë lekë;
- për krijimin e Agjencisë së Garantimit të Depozitave, 400 milionë lekë.

Neni 13

Në fondet e kushtëzuara përfshihen shpenzimet për investime nga financimet e huaja dhe shpenzimet nga të ardhurat që, me ligj ose me akte të tjera nënligjore, u përkasin ministrive dhe institucioneve të tjera buxhetore. Fondet e kushtëzuara, me përjashtim të financimeve të huaja, përdoren brenda vitit buxhetor.

Neni 14

Fondet buxhetore për pushtetin gjyqësor paraqiten në tabelën nr.3. Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 8363, datë 1.7.1998 “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”. Bordi i kësaj zyre mund të rishpërndajë deri në 10 për qind të të gjitha fondeve për çdo nivel të pushtetit gjyqësor, si dhe të miratojë çdo transferim ndërmjet gjykatave të të njëjtit nivel, duke respektuar raportet ndërmjet shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, të cilat paraqiten në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 15

Transferta e pakushtëzuar (granti), që Buxheti i Shtetit (qendror) i transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve, që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Transferta e pakushtëzuar shpërndahet ndërmjet organeve të pushtetit vendor, sipas formulës në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi rezervë nga shuma e përgjithshme e transfertës së pakushtëzuar dhe granti ekualizues përdoren nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministria e Financave, sipas kriterëve të përcaktuara në aneksin nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo organ të pushtetit vendor është në tabelën nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji. Financimi i funksioneve të deleguara në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë jepet në aneksin nr.3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Rritja e fondit të pagave nga granti në organet e pushtetit vendor nuk duhet të jetë më e madhe se 10 për qind mbi nivelin e vitit 2002.

Fondet, që sipas këtij neni, i vihen në dispozicion organeve të pushtetit vendor, fondet e tjera që me akte të tjera ligjore dhe nënligjore i kalojnë organeve të pushtetit vendor, si dhe vendimet e këshillave të organeve të pushtetit vendor për përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.

Neni 16

Kufijtë e shpenzimeve, sipas pasqyrave 1 dhe 2, mund të rishpërndahen gjatë vitit midis ministrive dhe institucioneve nga Këshilli i Ministrave, deri në masën 10 për qind të të gjitha fondeve të miratuara për çdo ministri dhe institucion.

Neni 17

Kufiri për rritjen vjetore të shumës së përgjithshme ekzistuese të borxhit të shtetit, si dhe borxheve të garantuara nga shteti, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2003 është 60 100 milionë lekë, i ndarë si më poshtë:

1. Kufiri për rritjen vjetore të shumës së përgjithshme ekzistuese të borxhit të shtetit, si rezultat i zbatimit të buxhetit të vitit 2003, është 42 000 milionë lekë, nga i cili:

- për kreditë e jashtme të drejtpërdrejta të Këshillit të Ministrave është 21 900 milionë lekë.
- për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor me bono thesari është 20 100 milionë lekë.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është 5 100 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të jashtme të papaguara është 13 000 milionë lekë.

Neni 18

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

Shpallur me dekretin nr. 3648, datë 8. 1. 2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.